



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË  
TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM  
FIER**

**Prokuroria Fier kërkon konfiskimin e 5 apartamenteve, rreth 17.000 m2 tokë arë dhe kuotat e 5 shoqërive të të dënuarit në Itali për drogë dhe personave të lidhur me të**

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, përfundoi hetimin pasuror dhe kërkon konfiskimin e 5 apartamenteve, 2 njësi shërbimi, 16.719 m2 tokë arë dhe kuotat e 5 shoqërive të shtetasit A.H. dhe personave të tjerë të lidhur me të, pasi rezultoi se janë krijuar si pasojë e veprimtarive të dyshuara kriminale.

Nga hetimet mbi procedimin pasuror nr.1, datë 01.07.2025, me objekt hetimi pasuritë në pronësi të shtetasve A.H, M.H, A.H, A.H dhe K.H, si dhe 5 shoqëritë tregtare në pronësi të tyre, Prokuroria pranë Gjykatë së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Fier arriti të dokumentojë pasuri të pajustificuara nga burimet e ligjshme.

Nga hetimi rezulton se ortakut i vetëm i shoqërisë “A...” sh.p.k., shtetasi A.H., ka deklaruar financimin e shoqërisë me një vlerë prej 100,072,890 Lek, e cila nuk justifikohet me burime të ligjshme financimi. Nëpërmjet kësaj shoqërie, u krijuan edhe shoqëritë e tjera të shpërndara midis anëtarëve të familjes.

Po ashtu rezultoi se janë kryer veprime fiktive me qëllim justifikimin e kësaj shume monetare, të cilat nuk mbështeteshin në mundësinë reale financiare për marrjen e kësaj shume nga burime të ligjshme. Përkundrazi, evidentohet se shumica e veprimeve janë kryer jashtë sistemit bankar, në “cash” dhe nëpërmjet akteve jo noteriale, me qëllim shmangien e origjinës së ligjshme të fondeve të investuara në shoqëri.

Shuma 100,072,890 Lek, e cila nuk mbështetet në burime të ligjshme dhe të deklaruara, ka shërbyer si bazë për zhvillimin e aktivitetit ekonomik të shoqërive në vijim, duke u reflektuar në pasqyrat financiare si burim i ligjshëm dhe më pas duke u përdorur për investime të ndryshme, përfshirë blerjen e automjeteve dhe krijimin e të ardhurave që janë shpërndarë në formë page dhe dividendi. Më tej, këto të ardhura janë rinvestuar në pasuri të paluajtshme dhe kuota shoqërisë, duke krijuar një cikël ekonomik që mbështetet në një burim fillestar të pajustificuar.

Shtetasi A.H., i dënuar nga autoritetet italiane për veprën penale “Përfitimi i të ardhurave që burojnë nga aktivitetet kriminale, drogë”, sillte në Shqipëri vlera monetare që buronin nga

veprimtaria kriminale në fushën e narkotikëve. Nga hetimet rezultoi se disa shoferë të punësuar në shoqëritë në zotërim të subjekteve në këtë hetim “A....” sh.p.k. dhe “A..... T....” sh.p.k, janë konstatuar duke sjellë vlera monetare të padeklaruarra në kufi, në rrethana të dyshimta mbi origjinën e tyre.

**Në përfundim të hetimit pasuror të plotë, Prokuroria Fier kërkon konfiskimin e pasurive të paluajtshme në emër të A.H. dhe M.H.**

1. Pasuria e llojit “apartament” me sipërfaqe 135.60 m<sup>2</sup>, me vendndodhje Bashkia Fier;
2. Pasuria e llojit “apartament” me sipërfaqe 127 m<sup>2</sup>, me vendndodhje Bashkia Fier;
3. Pasuria e llojit “apartament” me sipërfaqe 59 m<sup>2</sup>, me vendndodhje Bashkia Fier;
4. Pasuria e llojit “njësi” me sipërfaqe 17.10 m<sup>2</sup>, me vendndodhje Tiranë; dhe
5. Pasuria e llojit “njësi” me sipërfaqe 31 m<sup>2</sup>, me vendndodhje Vlorë.

**Konfiskimin e pasurive të paluajtshme në emër të shoqërisë “A...” Sh.p.k.:**

1. Pasuria e llojit tokë “arë”, me sipërfaqe 3949 m<sup>2</sup>, me vendndodhje Fier.

**Konfiskimin e pasurive të paluajtshme në emër të shoqërisë “A I” sh.p.k.:**

1. Pasuria e llojit tokë “arë”, me sipërfaqe 1971 m<sup>2</sup>, me vendndodhje Fier;
2. Pasuria e llojit tokë “arë”, me sipërfaqe 3926 m<sup>2</sup>, me vendndodhje Fier;
3. Pasuria e llojit tokë “arë”, me sipërfaqe 2942 m<sup>2</sup>, me vendndodhje Fier; dhe
4. Pasuria e llojit tokë “arë”, me sipërfaqe 3931 m<sup>2</sup>, me vendndodhje Fier.

**Konfiskimin e pasurive të paluajtshme në emër të K.H, si më poshtë:**

1. Pasuri e llojit “apartament”, me sipërfaqe 55 m<sup>2</sup>, me vendndodhje Bashkia Fier; dhe
2. Pasuri e llojit “apartament” me sipërfaqe 137 m<sup>2</sup>, me vendndodhje Bashkia Fier.

**Konfiskimin e kuotave të shoqërive tregtare në zotërim të individëve objekt hetimi pasuror, si më poshtë:**

1. Kuotat e shoqërisë “A....” sh.p.k;
2. Kuotat t shoqërisë “A... T....” sh.p.k;
3. Kuotat e shoqërisë “A... B...” sh.p.k;
4. Kuotat e shoqërisë “A.... I...” sh.p.k.; dhe
5. Kutoat e shoqërisë “M... T....” sh.p.k.

Prokuroria Fier shpreh angazhimin e plotë për ndjekjen me prioritet të identifikimit dhe konsifikimit të pasurive që rrjedhin nga aktiviteti kriminal.